

TIPOLOGJI NDËRKOMBËTARE TË PASTRIMIT TË PARAVE NËPËRMJET TRANSAKSIONEVE KOMPLEKSE

RASTI 1 - Lituani

Organet policore të Polonisë u informuan në lidhje me transportin fizik të parave, nga një grup i krimit të organizuar nga Polonia në Letoni, përmes territorit të Lituanisë, të kryer nga shtetas lituanez dhe letonezë.

Hetimi u nis në bashkëpunim me organet kompetente të vëndeve përkatëse. Në fazat e hershme të hetimit, u identifikuan lidhje me bashkëpunëtorë nga Republika Çeke dhe Ukraina dhe hetimet u shtrinë dhe në ato vënde.

U konstatua se drejtuesi i grupit, ishte një shtetas vietnamez me banim në Ukrainë, i cili u jepte udhëzime tre personave në Lituani, të cilët në mënyrë sistematike (2-3 herë në javë) transportonin fizikisht të ardhura të jashtëligjshme nga Gjermania, Republika Çeke dhe Polonia nëpërmjet Lituanisë në Letoni. Shuma e transportuar në çdo rast ishte rreth 250,000-300,000 EUR.

Hetimi tregoi se aktivitetet kriminale të kryera nga ky grup, lidheshin me importin e mallrave të konsumit me çmime të ulëta (për të shmangur taksat e BE-së) që rezultonte në fonde të konsiderueshme në të holla, të cilat më pas duhej të kalonin procesin e pastrimit të parave dhe më pas transferoheshin tek furnitorët në Azi.

U identifikuan tre grupe të korrierëve të parave, nga të cilat njëri përbëhej nga përfaqësues të një banke Letoneze dhe dy të tjerët vepronin në vëndet e Balltikut dhe vënde të tjera, duke ofruar shërbime të pastrimit të parave. Roli i grupit që vepronte në Letoni ishte të këmbente paratë e fituara në mënyrë kriminale në produkte financiare, kryesisht përmes llogarive bankare të hapura në emër të kompanive të regjistruara në parajsat fiskale.

Paratë transportoheshin në Letoni përmes korrierëve të parave, të cilët ua dorëzonin grupeve të tjera që kishin gjëndje fondesh në llogaritë e tyre bankare. Pas marrjes së këtyre fondeve, grupi i dytë kryente transfertat nga bankat Letoneze në llogaritë e shtetasve Lituanëz në Singapor, Hong Kong dhe Kinë, si pagesa për mallrat e blera. Në procesin e hetimit, është vlerësuar se me kalimin e kohës 100 - 300 milion dollar, janë legalizuar në këtë mënyrë.

Në procesin e hetimit, u zbuluan si një degë tjetër e skemës rreth 60 kompani, ku lidhja ishte grupi i pastrimit të parave që vepronte në Letoni. Burimi kryesor i fondeve në këtë rast, ishin veprat e mashtrimit tatimor të kryera në Letoni dhe Lituani (ndoshta dhe në vënde të tjera) për legalizimin e skrapit të çelikut të blerë jozyrtarisht.

Hetimi përfshinte gjithsej 170 llogari bankare, në të cilat ishin kryer mbi 150,000 transaksione. U arrestuan tre korrier parash (shtetas Lituanëz) dhe u sekuestruan 265,000 EUR të gjetura brenda makinës së tyre. Fondet e përdorura në skemën e Pastrimit të Parave (më shumë se 4,000,000 EUR në total) të gjetura në llogaritë bankare të 60 kompanive, u sekuestruan. Autoritetet Lituanëze konsiderojnë se ky rast është një shembull i mirë i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të informacionit. Bashkëpunimi synonte jo vetëm mbrojtjen e interesave të Lituanisë, por edhe për të përjashtuar aktet e dëmshme për buxhetin e Bashkimit Evropian, për të identifikuar flukset e jashtëligjshme të parave dhe për të çmontuar rrjetet kriminale ndërkombëtare.

Treguesit kryesor:

- Transferta me vendet parajsa fiskale;
- Përfshirja e shumë vëndeve në skemën e pastrimit të parave;
- Shumë palë ose persona të përfshirë, në raportin e aktivitetit të dyshimtë;
- Përdorimi i korrierëve të parave;
- Transaksionet me para në dorë në shuma të mëdha dhe përdorimi i kartëmonedhave me prerje të lartë;
- Numri i madh i transfertave, ndërmjet një grupi individësh dhe llogarive të kryera në mënyrë sistematike;

RASTI 2 – San Marino

Rasti përfshinte dy organizata të ndryshme kriminale të cilat bashkëpunonin për qëllime të pastrimit të parave. Grupi i parë përbëhej nga shtetas Kinez, të përfshirë në aktivitete të jashtëligjshme si kontrabanda e mallrave dhe emigrantëve (nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve të identifikimit). Fondet e përfituara në mënyrë të jashtëligjshme, transferoheshin kryesisht përmes dërgesave të parave në Kinë.

Sistemet bankare dhe financiare të San Marinos u përdorën si një mekanizëm plotësues, për transferimin e fondeve të jashtëligjshme (kryesisht) në Kinë, në favor të:

- personave fizikë Kinez;
- Subjektet juridike me emra anglisht, gjë që i çoi hetuesit në përfundimin se ishin të krijuar në vende të tjera.

Hetimet financiare të kryera nga autoritetet e San Marinos treguan se grupi Kinez kontaktoi institucionet financiare me të cilët kërkonin të krijonin marrëdhënie biznesi dhe më pas ata kryen depozitime me para në dorë.

Grupi i dytë ishte i tipit mafioz dhe kishte nevojë për para për të financuar aktivitetet e tyre të jashtëligjshme, siç ishte kredidhënia me fajde.

Grupi dispononte çeqe të përftuara nga mashtrimet e TVSH-së ose të lëshuara nga subjekte të ligjshme në favor të kompanive fiktive, që ngjanin me sektorin e pasurive të paluajtshme, por që në fakt përdorëshin vetëm për të simuluar veprimtari tregtare të ligjshme.

Bazuar në regjistrin tregëtar, të gjitha këto subjekte ishin krijuar vitet e fundit, nga persona që përdorëshin për të fshehur pronarët përfitues real. Për të fshehur gjurmët, zyrat e tyre u transferuan disa herë në qytete të ndryshme të vëndit.

Për qëllime të pastrimit të parave, anëtarët e këtyre grupeve krijuan marrëdhënie biznesi në institucionet bankare dhe financiare në San Marino: grupi i tipit mafioz hapi llogaritë dhe depozitoi çeqet e tyre dhe tërhoqi menjëherë vlerën me para në dorë, nga gjëndja e llogarive e krijuar dhe nga depozitat e klientëve Kinezë.

Në të njëjtën kohë, një pjesë e fondeve të krijuara nga depozitimi i çeqeve, u përdorën më pas për të kryer transfertat bankare në Kinë. Ky sistem plotësonte kërkesat e të dy grupeve: paratë nga aktivitetet ilegale Kineze përdorëshin nga grupi i tipit mafioz për të kryer aktivitete të jashtëligjshme, ndërsa fondet e krijuara nga çeqet (aktivitetet e jashtëligjshme të grupit mafioz) depozitoheshin në llogaritë rrjedhëse dhe më pas transferoheshin në llogari bankare, në favor të personave të përcaktuar nga klientët Kinez.

Treguesit kryesor:

- Shumë palë ose persona të përfshirë në raportin e dyshimtë;
- Lidhjet me grupet e krimit të organizuar;
- Transaksione të konsiderueshme me para në dorë;
- Depozitat e strukturuara me para në dorë të përdorura për të garantuar kreditë;
- Përfshirja e disa vëndeve në këtë skemë;
- Përdorimi i llogarive të përkohshme të tranzitit dhe llogarive të ndërmjetme (*escrow*);
- Numri i madh i transfertave ndërmjet një grupi individësh dhe llogarive të kryera në mënyrë sistematike.

RASTI 3 – Bullgari

Kjo tipologji bazohet në një sërë raportesh të aktivitetit të dyshimtë të dërguara nga subjekte të ndryshme raportuese. Në fillim, skema ishte e thjeshtë dhe përbëhej nga krime të shumta në internet (kryesisht mashtrime me virus Trojan) të kryera jashtë vendit dhe të lidhura me vjedhjen e të dhënave të identitetit të personave fizikë, por me kalimin e kohës skema u bë më e ndërlikuar.

Të ardhurat transferoheshin nga llogaritë bankare të viktimave në llogaritë bankare Bullgare, të hapura në emër të personave fizikë ose juridikë që kontrolloheshin nga grupet kriminale. Më pas, fondet tërhiqeshin nga individët që zotëronin llogaritë ose përfaqësuesit e tyre.

Një formë tjetër e mashtrimit në internet ishte kopjimi (*cloning*) i faqeve të internetit të bankave me qëllim vjedhjen e të dhënave personale, zbrazjen e llogarive bankare të viktimave dhe më pas transferimin e parave në llogaritë e hapura në bankat Bullgare nga persona fizikë.

Korrierët e parave, u rekrutuan në dy mënyra të ndryshme:

- Në skemën e parë, mijëra mesazhe elektronike ju dërgoheshin personave fizikë që kishin adresa Bullgare. Mesazhet përmbanin një tekst standard, i cili dukej sikur ishte përkthyer në Bullgarisht duke përdorur aplikacione të automatizuara përkthimi, duke lënë të kuptohej se teksti mund të ishte shkruar nga një shtetas Rus. Mesazhet ofronin një punë të mirëpaguar në një “kompani financiare ndërkombëtare”. Sipas informacionit të dhënë kompania ishte fitimprurëse pasi punësonte persona fizik për kërkimin e tregut. Për të vërtetuar kompetencat e tyre, kandidatëve iu kërkua të hapnin llogari bankare drejt të cilave transferoheshin fonde nën pragun e raportimit PP/FT. Këto fonde më pas, ata udhëzoheshin t'i tërhiqnin dhe pasi mbanin një komision të caktuar, më pas i transferonin paratë jashtë vendit (në një shtet të Evropës Lindore) nëpërmjet një kompanie transfertash.
- Në skemën e dytë, rekrutimi bëhej në mënyrë direkte pranë degëve të bankave. Anëtarë të grupeve kriminale, takonin personat që dilnin nga banka dhe i pyesnin nëse dëshironin të siguronin të ardhura. Atyre që u përgjigjën pozitivisht, ju transferohej një sasi relativisht e vogël parash (nën pragun e raportimit sipas legjislacionit në fuqi), të cilat ata supozohej t'i tërhiqnin, të mbanin komisionin e tyre dhe më pas t'i dërgonin paratë jashtë vendit (në të njëjtin vend të Evropës Lindore) nëpërmjet kompanive të transfertave. Ky sistem i dytë nuk ishte opsioni i preferuar për shkak të rrezikut më të lartë, pasi kërkonte kontakt personal me personat që rekrutoheshin dhe nëse korrieri arrestohej, mund të identifikonte rekrutuesin.

Treguesit kryesor:

- Shumë palë ose persona të përfshirë në raportin e dyshimtë;
- Përdorimi i korrierëve të parave;

- Numri i madh i transfertave, ndërmjet një grupi individësh dhe llogarive të kryera në mënyrë sistematike;
- Krimet elektronike të shoqëruara me shuma të konsiderueshme parash të përfshira në transaksione;
- Shuma të vogla fondesh, të transferuara jashtë vendit nëpërmjet kompanive të transfertave.

RASTI 4 – Mali i Zi

Rasti është iniciuar pas marrjes së dy raporteve të aktivitetit të dyshimtë (RAD), nga dy banka të ndryshme (në lidhje me transaksionet në shumën totale mbi 1,100,000 EUR). I njëjti person fizik (M) paraqitej si dërgues i fondeve në të dy RAD-të dhe qëllimi i deklaruar i transaksioneve ishte “ndihmë ose dhuratë”.

Sipas RAD-së së parë, klienti A hapi një llogari dhe një ditë më vonë një shumë e konsiderueshme u transferua nga M, nga një llogari e hapur në një bankë në vendin X. Klienti A më pas tërhoqi një pjesë të shumës. Sipas RAD-së së dytë (të marrë të nesërmen nga data e raportimit të RAD së parë), një klient tjetër, personi fizik B, i cili kishte hapur së fundmi një llogari, morri një shumë të konsiderueshme nga M, nga e njëjta bankë nga vendi X.

Në të njëjtën ditë, B e tërhoqi të gjithë shumën. Një tjetër transaksion u krye të nesërmen, sipas të njëjtit model dhe u bë një kërkesë për tërheqje të fondeve. Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) pezulloi kërkesën për tërheqje të parave të paraqitura nga B dhe kërkesat pasuese për tërheqje të parave të bëra nga A.

Më pas, NjIF mori informacion (nga një agjenci vëndase e zbatimit të ligjit) se personat e përfshirë në RAD ishin të lidhur dhe ishin pjesë e një grupi të organizuar kriminal dhe se kishte bashkëpunëtorë të tjerë të lidhur, të cilët synonin gjithashtu të kryenin transaksione të ngjashme të cilat do të përfundonin me tërheqje fondesh. Personat përgjegjës të përputhshmërisë ishin paralajmëruar nga NjIF në mënyrë që ata të mund të ndërmarrin veprimet e duhura nëse identifikoheshin transaksione të tilla.

Më pas, një RAD e tretë (që përfshin personin fizik C, i cili ishte pjesë e të njëjtit grup të organizuar) u dërgua në NjIF, pasi transaksioni kishte të njëjtën tipologji dhe fondet u transferuan nga i njëjti vend X. Mesazhi SWIFT nuk përmbante detaje në lidhje me dërguesin e fondeve apo qëllimin e transaksionit. Për më tepër, banka vëndase njoftoi NjIF se kishte marrë informacion nga banka e huaj porositëse se fondet ishin të ardhura nga mashtrimi në internet, duke kërkuar dhe kthimin e fondeve. Banka nuk ishte në gjendje t'i kthente fondet e përmendura për shkak se NjIF kishte nxjerrë një urdhër bllokimi, i cili u shoqërua me një vendim shtyrje nga Prokuroria.

Përpara identifikimit të skemës së pastrimit të parave, autoritetet kompetente shtetërore vunë re se subjektet (A, B dhe C), edhe pse të papunë, shpenzonin shuma të mëdha parash, blinin automjete luksoze dhe shpenzonin shuma të konsiderueshme në resorte turistike në bregdetin Malazet.

Ky ishte një tregues që çoi autoritetet drejt grupit Kriminal. NjIF-të e huaja informuan NjIF vëndas se personat nën hetim kishin të kaluar kriminale në vëndet e tyre. Si rezultat i këtyre veprimeve NjIF bllokoi përkohësisht 5 transaksione, për të cilat më pas doli dhe një urdhër sekuestrimi nga Prokuroria.

Treguesit kryesor:

- Shumë palë ose persona të përfshirë në raportin e dyshimtë;
- Disa RAD të raportuara;
- Lidhjet me grupet kriminale
- Transaksionet të konsiderueshme me para në dorë;
- Përfshirja e disa vëndeve në këtë skemë;

- Tregues të pjesëmarrjes në krime elektronike të shoqëruara me transaksione në vlera të konsiderueshme;

RASTI 5 – Bosnje dhe Hercegovinë

Pas një kërkesë ndërkombëtare për informacion, Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) filloi një analizë të transaksioneve të kryera nga një person me rol drejtues në trafikimin e lëndëve narkotike dhe bashkëpunëtorët e tij.

Pas hetimeve të kryera në Bosnje dhe Hercegovinë dhe jashtë saj, tre persona u paditën për pastrimin e 7 milion EUR në emër të një karteli droge.

Trafikimi drejt Evropës i sasive të mëdha të drogës, kryhej nga Amerika e Jugut. Veprat e penale nga të cilat ishin siguruar të ardhurat e sipërpërmëndura, ishin kryer në shtetet A dhe B dhe procedimet penale ishin ende në proces. Në Bosnje dhe Hercegovinë, çështja penale e PP u gjykua (bazuar në rrethana faktike objektive) kryesisht bazuar në të dhënat dhe informacionin e dhënë nga autoritetet e vendeve A dhe B.

Për pastrimin e të ardhurave, paratë e drogës u transferuan nga vendet A dhe B në llogari bankare të hapura në Bosnje dhe Hercegovinë. Transfertat kryheshin nga persona juridikë të regjistruar në vende të ndryshme (Bosnje dhe Hercegovina, shtetet A dhe B dhe disa parajsas fiskale), bazuar në fatura fiktive, kontrata të rreme tregtare, marrëveshje false për bashkëpunim të ndërsjellë, marrëveshje të huadhënies së parave etj..

Kompanitë boshnjake, formalisht ishin në pronësi të bashkëpunëtorëve të drejtuesit të grupit kriminal. Një pjesë e parave (1 milion EUR) ju kthyen kompanive në shtetet A dhe B. Një pjesë u transferua nga një kompani në A, tek një kompani në Bosnje dhe Hercegovinë, bazuar në një faturë të rreme për një dërgesë të supozuar të një sasive misri (që nuk ishte dorëzuar).

Një pjesë e kësaj shume, i mbeti kompanisë në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa pjesa tjetër ju transferua një kompanie në shtetin B, në bazë të një marrëveshjeje të rreme huadhënie në kuadrin e marrëdhënies së biznesit. Hetimi u krye nga NjIF, në bashkëpunim me njësitë policore në tre shtete nga i cili rezultoi se vlera totale e fondeve të pastruara, përmes përdorimit të personave juridik ishte 11,5 milion EUR (përfshirë aksione, asete tjera financiare dhe një aeroplan).

Treguesit kryesor:

- Transferta në parajsas fiskale me përshkrimin “hua”;
- Përfshirja e disa vendeve në këtë skemë;
- Fatura të shumta fiktive;
- Fonde të dërguara ose të marra në/nga vende të njohura për trafikimin e lëndëve narkotike dhe qënieve njerëzore, pa qëllim të dukshëm ligjor;
- Lidhjet me grupet kriminale.

RASTI 6 – Bullgari

Kompania A (person juridik bullgar), ishte subjekt i një raporti të dyshimtë bazuar në dyshimin se shuma të konsiderueshme, i ishin transferuar nga dy persona të tjerë juridikë bullgarë L dhe B (mbi 5 milion EUR në total) me shpjegimin “tregëtim i titujve”. Zakonisht operacionet në llogarinë e kompanisë A kryheshin nga dy përfaqësues, N dhe K. Kompanitë A dhe B kishin pronësi të përbashkët të lidhur, sipas raportimeve të mediave, me një grup të krimit të organizuar.

Gjatë analizës nga Njësia e Inteligjencës Financiare rezultoi se kompania A, kishte shitur aksionet që zotëronte në kompaninë B, përmes tregut të parregulluar të letrave me vlerë. Çmimi i shitjes së aksioneve ishte disa herë më i lartë se çmimi i të njëjtave aksione të tregtuara në bursën e rregulluar. Menjëherë pas marrjes së kundërvlerës së aksioneve, fondet transferoheshin në një llogari bankare të huaj të kompanisë Z (e krijuar në një vënd parajsë fiskale), me justifikimin “kredi me këste”.

Kredia në fjalë, e dhënë kompanisë A nga kompania Z, ishte në vlerën totale prej 6 milion EUR. Sipas kontratës, kredia ishte marrë me këste para 15 vitesh, por vetëm së fundmi ishte deklaruar në Bankën Kombëtare Bullgare.

Më pas, pagesa të tjera në shuma të mëdha u urdhëruan në llogarinë e kompanisë A nga dy persona të tjerë juridikë bullgarë me një justifikim të paqartë “sipas kontratës”. Fondet e grumbulluara u transferuan në mënyrë të përsëritur nga llogaria e kompanisë Z në kompaninë A dhe anasjelltas pa dhënë ndonjë shpjegim të arsyeshëm.

Treguesit kryesor:

- Transferta në vlera të konsiderueshme mes personash juridik;
- Pronarët përfitues të lidhur me grupe të krimit të organizuar;
- Shitje aksionesh mbi vlerën reale të tregut;
- Marrëdhënie biznesi me parajsë fiskale;
- Kontrata fiktive të huamarrjes;